317	Leonard Mirjan	Qamil Qamil	Baramaj Baramaj	3976	136/143	truall	300.00	36.5	479	17,483.50								0.00	17,483.50	Konfirmuar nga ASHK leje legalizimi nr. 721388 dt. 29.10.2015 godinë e kombinuar 2 kt. plus 1 nëntokë sip. e katit nëntokë 35.5 m² sip. e katit përdhe 178.4 m² sip. e katit të parë 220.4 m² OBJEKTET NUK PREKET NGA REALIZIMI I PROJEKTTT	
318	Erver	Skender	Sadiku	3976	136/141	truall	277.00	16.7	479	7,999.30								0.00	7,999.30	Konfirmuar nga ASHK leje legalizimi nr. 721572 dt. 24.11.2015 godinë banimi 2 kt. Sip. e katit përdhe 98.4 m² sip e katit të parë 114.9 m² OBJEKTET NUK PREKET NGA REALIZIMI I PROJEKTTT	
319	Sokrat	Xhelal	Zhupa	3976	136/381	truall	228.00	18.4	479	8,813.60								0.00	8,813.60	Konfirmuar nga ASHK leje legalizimi nr. 997156 dt. 31.3.2017 godinë banimi 2 kt sip. e katit përdhe 92 m² sip. e katit të parë 123.7 m² OBJEKTET NUK PREKET NGA REALIZIMI I PROJEKTTT	
320	Latif	Xhelal	Zhupa	3976	136/245	truall	245.80	10.4	479	4,981.60								0.00	4,981.60	Konfirmuar nga ASHK leje legalizimi nr. 994503 dt. 29.9.2016 godinë banimi 2 kt sip. e katit përdhe 114 m² sip. e katit të parë 133 m² OBJEKTET NUK PREKET NGA REALIZIMI I PROJEKTTT	
321	Agron	Mehmet	Hysenaj	3976	136/373	truall	171.20	21.5	479	10,298.50								0.00	10,298.50	Konfirmuar nga ASHK leje legalizimi nr. 997060 dt. 22.3.2017 godinë banimi 3 kate sip. e katit përdhe 79.5 m² (banimi 61.1 m²) sip. e katit të parë 96.5 m² sip. e katit të dytë 86.5 m² OBJEKTET NUK PREKET NGA REALIZIMI I PROJEKTTT	
322	Ramazan	Xhevit	Oshafi	3976	136/339	truall	500.00	18.2	479	8,717.80								0.00	8,717.80	Konfirmuar nga ASHK leje legalizimi nr 995656 dt. 15.11.2016	



																				godinë banimi 3 kat plus 1 kt. nëntokë plus godinë shërbimi 1 kt sip e katit nëntokë 159.3 m² sip e katit përdhe godinë banimi 159.3 m² (sip verande 27 m²) sip e katit 1 të parë 192.1 m² sip e katit të dytë 192.1 m² sip e katit përdhe social ekonomik 19 m² (sip verandë plus shkallë 2.1 m²) OBJEKTET NUK PREKJET NGA REALIZIMI I PROJEKTT
323	Agron	Elez	Ajazi	3976	136/309	truall	134.20	7.4	479	3,544.60								0.00	3,544.60	Konfirmuar nga ASHK leje legalizimi nr. 995715 dt 16.11.2016 godinë banimi 2 kat plus 1 kt. nëntokë sip e katit nëntokë sip banimi 25.2 sip ndërtimi 62.9 sip e katit përdhe 62.9 m² sip e katit pure 67 m² OBJEKTET NUK PREKJET NGA REALIZIMI I PROJEKTT
324	Dylber	Nuredin	Mata	3976	136/335	truall	409.00	19.1	479	9,148.90								0.00	9,148.90	Konfirmuar nga ASHK leje legalizimi nr. 980001 dt 18.7.2016 godinë banimi 1kt sip e katit përdhe 112.3 m² sip shkallë 1.2m² OBJEKTET NUK PREKJET NGA REALIZIMI I PROJEKTT
325	Indrit	Ramazan	Gordoni	3976	136/297	truall	242.30	46.7	479	22,369.30								0.00	22,369.30	Konfirmuar nga ASHK blokuar proma për 30 dit nga notari Lindita Durrësaj me dt. 2.11.2022 nëpërmjet aplikimit nr. 67889 leje legalizimi nr. 997373 dt. 28.4.2017 godinë banimi dy kt plus 1 kt. nëntokë sip e kt. nëntokë 75.3 m² sip e katit përdhe 75.3 m² sip verandë plus shkallë 18.6 m² sip kat i parë 110.2 m² OBJEKTET NUK PREKJET NGA REALIZIMI I PROJEKTT
326	Robert	Xhevdet	Uliu	3976	136/315	arc+truall	224.10	18	479	8,622.00								0.00	8,622.00	Konfirmuar nga ASHK leje legalizimi nr. 2622263 dt. 2.3.2018 godinë e kombinuar 2 kt plus 1 kt. nëntokë sip e



																						katit nëntokë 27.5 m² sip. e katit përdhe 110 m² sip. e katit të parë 110 m² sip. verandë 15 m² OBJEKTI NUK PREKET NGA REALIZIMI I PROJEKTI
327	HAJREDIN ILIR BESIM VELI HAVE HAYZI	ABDYLL HAJREDIN HAJREDIN HAJREDIN HAJREDIN	AHMATI AHMATI AHMATI AHMATI SHIRA AHMATI	2884	239	Truall+ Ndertese	300.00	72	3,560.00	256,320.00							250.00	250.00	52,000.00	13,000,000.00	13,256,320.00	Konfirmuar nga ASHK Kontratë sipërmarrje/ akt marrëveshje ndërmjet zhvilluesit të projeckt dhe pronarëve të trualit
328	PETREF	ISUF	MUSTAFA	2884	166	Truall+ Ndertese	300.00	74	3,560.00	263,440.00							53.80	53.80	52,000.00	2,797,600.00	3,061,040.00	Konfirmuar nga ASHK
329	Hydajet Bajram Skender	Ali Ali Ali	Kopani Kopani Kopani	3976	136/183	truall	500.00	49.6	479	23,758.40									0.00	23,758.40	Konfirmuar nga ASHK leje legalizimi nr. 79416 dt. 15.3.2016 godinë banimi 4 kt sip e katit përdhe 161.9 m² kat i parë 179.7 m² sip. e katit të dytë 179.7 m² sip. e katit tretë 179.7 OBJEKTI NUK PREKET NGA REALIZIMI I PROJEKTI	
SHUMA TOTALE										2,761,807.20					128,665.60		28,299,108.60			63,638,273.41	94,921,355.61	



VENDIM

Nr. 610, datë 2.10.2024

**PËR NJË SHITESË FONDI NË
BUXHETIN E VITIT 2024, MIRATUAR
PËR AGJENCINË KOMBËTARE TË
PLANIFIKIMIT TË TERRITORIT**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5 e 45, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të nenit 14, të ligjit nr. 97/2023, “Për buxhetin e vitit 2024”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Financave dhe të ministrit të Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Agjencisë Kombëtare të Planifikimit të Territorit, në buxhetin e miratuar për vitin 2024, i shtohet fondi prej 56 667 267 (pesëdhjetë e gjashtë milionë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e shtatë mijë e dyqind e gjashtëdhjetë e shtatë) lekësh, i ndarë, si më poshtë vijon:

a) 23 500 210 (njëzet e tre milionë e pesëqind mijë e dyqind e dhjetë) lekë, në zërin “Shpenzime korrente”, për përballimin e shpenzimeve për financimin e konkursit të projektimit për projektidetë e zhvillimit të “Expo Albania-s”.

b) 33 167 057 (tridhjetë e tre milionë e njëqind e gjashtëdhjetë e shtatë mijë e pesëdhjetë e shtatë) lekë, në zërin “Shpenzime për investime”, për përballimin e shpenzimeve për marrjen e projektidesë përfundimtare për “Expo Albania-n”.

2. Efekti financiar, prej 56 667 267 (pesëdhjetë e gjashtë milionë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e shtatë mijë e dyqind e gjashtëdhjetë e shtatë) lekësh, përballohet nga fondi rezervë i buxhetit të shtetit, miratuar për vitin 2024.

3. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku**

VENDIM

Nr. 612, datë 2.10.2024

**PËR MIRATIMIN E MARRËVESHJES
NDRYSHUESE ME SHKËMBIM
LETRASH TË MARRËVESHJES SË
HUAS, NDËRMJET REPUBLIKËS SË
SHQIPËRISË DHE BANKËS
NDËRKOMBËTARE PËR RINDËRTIM
DHE ZHVILLIM, PËR FINANCIMIN
SHITESË PËR PROJEKTIN
“PËRMIRËSIMI I SISTEMIT TË
SHËNDETËSISË”, RATIFIKUAR ME
LIGJIN NR. 52/2022**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 19 e 23, të ligjit nr. 43/2016, “Për marrëveshjet ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin e marrëveshjes ndryshuese me shkëmbim letrash të marrëveshjes së huas, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim, për financimin shtesë për projektin “Përmirësimi i sistemit të shëndetësisë”, ratifikuar me ligjin nr. 52/2022, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku**



BANKA BOTERORE
IBRD . IDA I GRUP I BANKES BOTERORE

XIAOQING YU
Drejtor vendi, Ballkani Perëndimor
Rajoni i Evropës dhe Azisë Qendrore

ZYRA E GRUPIT TË BANKËS
BOTËRORE
Praterstrasse 31/21
Vienna, Austria, 1020

Shkëlqesisë së Tij, Ervin Mete5 qershor, 2024

Ministër

Ministria e Financave dhe Ekonomisë

Tiranë

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

I nderuar z. Ministër,

Projekti për Përmirësimin e Sistemit Shëndetësor - financim shtesë

(Numri i huas 9306-AL)

Zgjatja e datës së mbylljes

Ne i referohemi Marrëveshjes së Huas (“Marrëveshja e Huas”) ndërmjet Republikës së Shqipërisë (“Huamarrësi”) dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim (“Banka Botërore”), datë 29 prill 2022, për financimin shtesë (FSH) të Projektit të Përmirësimit të Sistemit Shëndetësor (“Projekti”) dhe letres suaj të datës 27 maj 2024 që kërkon zgjatjen e datës së mbylljes së huas së lartpërmendur.

Ndërsa vërejmë kërkesën tuaj për një zgjatje të datës së mbylljes së huas deri më 31 dhjetor 2025, dëshirojmë t’iu informojmë se duke pasur tashmë parasysh kohën e gjatë të zbatimit të Projektit të Përmirësimit të Sistemit Shëndetësor, Banka Botërore mund të pranojë vetëm një periudhë zgjatjeje gjashtëmujore të datës së mbylljes së huas deri më 30 qershor 2025, si datë e mëvonshme për qëllimin e seksionit III.B.2 të skedulit 2 të Marrëveshjes së Huas.

Në shumë takime, ekipi ynë i ka përcaktuar në mënyrë të vazhdueshme ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale (MSHMS) zgjatjen e lartpërmendur gjashtëmujore. Në ato raste, ne kemi marrë garanci se aktivitetet e mbetura pezull do të përfundojnë brenda afatit kohor të rishikuar (30 qershor 2025) me angazhimin e MSHMS-së dhe ekipit të Bankës Botërore për të punuar në një mënyrë të shpejtë dhe për të ruajtur mbikëqyrjen javore të aktiviteteve të projektit. Më tej, ekipi ynë ka përcjellë vazhdimisht se çdo aktivitet projekti që nuk mund të përfundojë deri në datën e rishikuar të mbylljes, do të duhet të merret përsipër nga Qeveria e Shqipërisë dhe të financohet nga burimet tuaja financiare.

Në përputhje me praktikën aktuale të Bankës, disbursime të mëtejshme nga Huaja do të bëhen për aplikimet për tërheqje të marra nga Banka në mbyllje të aktivitetit më 31 tetor 2025, në lidhje me shpenzimet e pranueshme të bëra deri në datën e mbylljes (specifikisht pagesat e kryera ose pagesat për mallra, punë dhe shërbime ose shpenzime të tjera të pranueshme që janë siguruar para datës së mbylljes). Të ardhurat e huas që mbeten të patërhequra pas kryerjes së disbursimeve në lidhje me këto aplikime për tërheqje, do të anulohen.

Me përjashtim të ndryshimeve specifike në këtë letër, të gjitha dispozitat e tjera të Marrëveshjes së Financimit mbeten në fuqi dhe efekt të plotë.

Me respekt,

Xiaoqing Yu

Drejtor vendi, Ballkani Perëndimor
Rajoni i Evropës dhe Azisë Qendrore
(*Nënshtkrimi*)

Për dijeni: Shkëlqesisë së Saj, Albana Koçiu, ministre e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale
Znj. Agathi Kurameno, shefe e Kabinetit të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale
Znj. Adela Xhemali, zv.ministre e Financave
Znj. Jona Suli, drejtore e SASPAC-ut
Z. Matteo Bugamelli, drejtor ekzekutiv i Bankës Botërore

Tel: +43 (1) 2170 782 Faks: +43 (1) 2170 701



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCËVE
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E BORXHIT SHTETËROR
DREJTORIA E MARRËVESHJEVE DHE SIGURIMIT TË NDIHMËS SË HUAJ

Nr. 8060/3 prot.

Tiranë, më 24.9.2024

Lënda: Mbi Projektin "Përmirësimi i sistemit të shëndetësisë".

ZYRËS SË BANKËS BOTËRORE
Adresa: "Dëshmoret e 4 Shkurtit" nr.34 Tiranë ✓

Për dijeni:

XIAOQING YU
Drejtoresh Rajonale, Ballkani Perëndimor

I referohem Marrëveshjes së Huasë për financimin shtesë ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim, për Projektin "Përmirësimi i Sistemit të Shëndetësisë".

Në vijim të shkresës suaj datë 05.06.2024 ku konfirmoni shtyrjen deri më 30 Qershor 2025 të afatit të disbursimit të parashikuar sipas skedulit 2, neni III (B.2) të Marrëveshjes së Huasë për financimin shtesë, shprehim dakordësinë tonë me këtë afat.

Kjo letër së bashku me letrën tuaj do të përbëjnë marrëveshjen ndryshuese, me shkëmbim letrash të marrëveshjes së huasë për financimin shtesë ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim, për Projektin "Përmirësimi i Sistemit të Shëndetësisë".

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin.

MINISTER
Petrir Malaj

**VENDIM**

Nr. 613, datë 2.10.2024

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 111, DATË 23.2.2018, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR KRIJIMIN DHE FUNKSIONIMIN E FONDIT SOCIAL”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 4, të nenit 24, të ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar, dhe të pikës 4, të nenit 47, të ligjit nr. 121/2016, “Për shërbimet e kujdesit shoqëror”, me propozimin e ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, të ministrit të Shtetit për Pushtetin Vendor dhe të ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. Në vendimin nr. 111, datë 23.2.2018, të Këshillit të Ministrave, bëhen këto ndryshime:

1. Pika 1 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“1. Krijimin dhe administrimin e fondit social nga njësitë e qeverisjes vendore, në bashkëpunim me ministrinë përgjegjëse për çështjet sociale, për të siguruar zhvillimin e politikave sociale, përmirësimin e standardeve dhe kapaciteteve administruese të shërbimeve ekzistuese, si dhe planifikimin e krijimit e shërbimeve të reja.”.

2. Pika 4.1 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“4.1 Njësia e vetëqeverisjes vendore vlerëson nevojat për ofrimin e shërbimeve të kujdesit shoqëror në nivel vendor dhe harton planin social vendor, duke identifikuar ato shërbime që mbeten të pafinancuara, bazuar në programin buxhetor afatmesëm.”.

II. Ngarkohen ministria përgjegjëse për çështjet sociale, ministri përgjegjës për pushtetin vendor dhe ministria përgjegjëse për financat për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDESKRYEMINISTËR
Belinda Balluku

UDHËZIM

Nr. 757, datë 30.9.2024

PËR PROCEDURAT E SHQYRTIMIT, VLERËSIMIT DHE MIRATIMIT TË KËRKESAVE PËR LICENCIM, TË SUBJEKTEVE QË KRYEJNË VEPRIMTARI TË NDËRMJETËSIMIT NË TREGUN E PUNËS DHE MONITORIMIN E TYRE

Në mbështetje të nenit 102, pika 4 e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në zbatim të ligjit nr. 7961, datë 12.7.1995, “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar, të ligjit nr. 15/2019, “Për nxitjen e punësimit”, i ndryshuar, të nenit 20, të ligjit nr. 10081, datë 23.2.2009, “Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe të pikës 5, kreu II, të vendimit nr. 538, datë 26.5.2009, të Këshillit të Ministrave, “Për licencat dhe lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet Qendrës Kombëtare të Licencimit (QKL) dhe disa rregulla të tjera nënligjore të përbashkëta”, i ndryshuar si dhe në zbatim të planit të veprimeve të “Strategjisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive”,

UDHËZOJ:**KREU I**
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME**Neni 1****Fusha e zbatimit dhe qëllimi i udhëzimit**

a) Fusha e zbatimit të këtij udhëzimi është licencimi i subjekteve private që zhvillojnë veprimtari në fushën e ndërmjetësimit në tregun e punës sipas nënkategorisë X.2.A.

b) Qëllimi i udhëzimit është përcaktimi i procedurave të shqyrtimit dhe vlerësimit të kërkesave për licencim të subjekteve private që kryejnë veprimtari të ndërmjetësimit në tregun e punës, si dhe monitorimit në vijimësi të tyre pas licencimit.

Neni 2**Përkufizime**

Termat e përdorur në këtë udhëzim do të kenë kuptimin që kanë në legjislacionin kombëtar për punësimin, për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë, si dhe në legjislacionin në fuqi, në bazë të të cilit ushtrojnë veprimtarinë ndërmjetësuesit në tregun e punës.



KREU II
PROCEDURA PËR SHQYRTIMIN DHE
VLERËSIMIN E KËRKESAVE PËR
LICENCIM TË SUBJEKTEVE PRIVATE
QË KRYEJNË VEPRIMTARI TË
NDËRMJETËSUESIT NË TREGUN E
PUNËS DHE DOKUMENTACIONI
SHOQËRUES

Neni 3

**Kërkesat dhe dokumentacioni i kërkuar për
përfitimin e licencës**

1. Kërkesa dhe dosja e aplikuesit për licencë duhet të përmbajë dokumentet provuese dhe shoqëruese për plotësimin e kriterëve të posaçme të licencimit për nënkategorinë X.2.A.
2. Drejtuesi teknik duhet të deklarohet në ekstraktin e subjektit.
3. Drejtuesi teknik nuk lejohet të regjistrohet në më shumë se dy subjekte.
4. Dokumentet vërtetuese të përcaktuara për licencim duhet të jenë origjinal ose të njehsuara me origjinalin.
5. Dokument vërtetues për ngurtësimin e një kapitali si rezervë sigurie për të tretët, në vlerën e pesë pagave minimale.
6. Dokumentet në gjuhë të huaj duhet të jenë të përkthyer dhe të njehsuara me origjinalin.

Neni 4

**Procedura e shqyrtimit të dokumentacionit
të aplikimit për licencë X.2.A**

1. Kërkesat e subjekteve fizike/juridike, që zhvillojnë veprimtari të ndërmjetësimit në tregun e punës, që kanë aplikuar në Qendrën Kombëtare të Biznesit (QKB) për t'u pajisur me licencë për ndërmjetësimin në tregun e punës, kalojnë në mënyrë elektronike pranë Drejtorisë së Politikave të Punësimit dhe Migratore, në Ministrinë Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit.
2. Personi përgjegjës pranë kësaj drejtorie bën regjistrimin e kërkesës në regjistrin elektronik të krijuar për këtë qëllim menjëherë nga marrja e tij.
3. Personi përgjegjës pranë kësaj drejtorie verifikon plotësinë e dokumentacionit provues dhe shoqërues të përcaktuar për kriteret e posaçme të kategorisë X.2.A. Në rast se gjatë shqyrtimit paraprak konstatohen mangësi në dokumentacion refuzon kërkesën.

4. Në rast se dokumentacioni provues është i plotë përcillet pranë inspektoratit shtetëror, që mbulon fushën e punës për inspektimin në vend e vlerësimin faktik të plotësimit të kriterëve përkatëse të licencimit, në rrugë elektronike, jo më vonë se dita pasardhëse e punës.

Neni 5

**Procedura e inspektimit në vend dhe
vlerësimit të përmbushjes së kriterëve të
licencimit**

- Inspektorati shtetëror, që mbulon fushën e punës nëpërmjet strukturave të tij, ndjek hapat si më poshtë:
1. Me marrjen e kërkesës së dërguar në rrugë elektronike shqyrton dokumentacionin e aplikimit, i cili përfshin dokumentet provuese dhe shoqëruese nëse janë në përputhje me aktet rregullatore në fuqi jo më vonë se dita tjetër e punës.
 2. Bën inspektimin në vend, inspektim i cili konsiston në plotësimin e kriterëve të posaçme.
 3. Në rast se gjatë inspektimit vihen re mospërputhje/pasaktësi të deklaramit në lidhje me plotësimin e kriterëve të posaçme, apo mospërputhje me deklaramet e bëra nëpërmjet dokumentacionit, i pasqyron në procesverbalin sipas shtojcës numër një, të mbajtur për këtë qëllim.
 4. Konstatimet gjatë inspektimit dokumentohen të pasqyruara në procesverbal firmosen edhe nga përfaqësuesi ligjor i subjektit apo një person i autorizuar prej tij dhe grupi i inspektimit.
 5. Pas kryerjes së shqyrtimit të dokumentacionit dhe inspektimit në vend, dërgon zyrtarisht procesverbalin e vlerësimit faktik sipas shtojcës një, të plotësimit ose jo të kriterëve përkatëse të licencimit brenda 7 (shtatë) ditëve, nga marrja e kërkesës dërgohet në drejtorinë përkatëse në ministrinë përgjegjëse për çështjet e punës.

KREU III

PROCEDURAT E VENDIMARRJES PËR
LICENCIM TË SUBJEKTEVE PRIVATE QË
KRYEJNË VEPRIMTARI TË
NDËRMJETËSIMIT NË TREGUN E PUNËS

Neni 6

Procedura që ndiqet nga drejtoria përkatëse

1. Personi përgjegjës në drejtorinë përkatëse në ministrinë përgjegjëse për çështjet e punës, përgatit dosjen e cila kalon për vendimarrje te ministri.



2. Vendimi i miratimit nga ministri, bazohet në dokumentet provuese të licencimit, si dhe në inspektimin në vend e vlerësimin faktik të plotësisë së kriterëve përkatës të licencimit nga inspektorati shtetëror, që mbulon fushën e punës.

3. Ministri, vendos për:

a) miratimin e kërkesës për pajisje me licencë.

b) refuzimin e kërkesës për pajisje me licencë.

4. Në rast se kërkesa miratohet, vendimi miratues, publikohet në Qendrën Kombëtare të Biznesit, e cila pajis me licencë subjektin ofrues të ndërmjetësisë në punë me kodin X.2.A.

Neni 7

Ankimi ndaj vendimit

1. Në rast se kërkesa refuzohet, arsyetimi ligjor përkatës, në të cilin përcaktohen qartë shkaqet e refuzimit, publikohet në Qendrën Kombëtare të Biznesit.

2. Nëse subjekti nuk është dakord me vendimin e marrë për refuzimin e kërkesës për licencim, ai ka të drejtën e ndjekjes së procedurës së ankimimit sipas nenit 30 të ligjit nr. 10081, datë 23.2.2009, “Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, brenda 10 (dhjetë) ditëve nga dita e marrjes së njoftimit për refuzimin e kërkesës.

3. Ministria përgjegjëse për çështjet e punës, në zbatim të pikës 3, të nenit 30 të ligjit nr. 10081, datë 23.2.2009, “Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë” shqyrton ankimimin dhe merr vendim brenda 10 ditëve nga data e depozitimit të tij dhe ja komunikon ankuesit.

KREU IV

PROCEDURA E MONITORIMIT TË AKTIVITETIT TË SUBJEKTEVE PRIVATE TË LICENCUARA PËR NDËRMJETËSIM NË TREGUN E PUNËS

Neni 8

Monitorimi periodik dhe revokimi i licencës

1. Subjektet e licencuara sipas këtij udhëzimi, i nënshtrohen një kontrolli periodik të paktën 1 (një) herë në vit, i cili kryhet nga inspektorati shtetëror që mbulon fushën e punës dhe/ose nga drejtoria përkatëse në ministrinë përgjegjëse për çështjet e

punësimit, sipas planit të punës së miratuar nga drejtori i përgjithshëm.

2. Kontrolli periodik bëhet mbi verifikimin dhe ruajtjen e kriterëve të licencimit si dhe për dokumentimin e të dhënave të/për aktivitetin nga subjekti i licencuar në përputhje me përcaktimet kuadrit rregullator në fuqi.

3. Pas licencimit subjekti duhet të hartojë dhe të ruajë në vazhdimësi të dhënat dhe dokumente për ndërmjetësimet sipas dokumenteve si më poshtë:

a) Regjistër, me numrin identifikues përkatës për çdo të ndërmjetësuar;

b) Dokumentin identifikues të ndërmjetësuarit;

c) Regjistër me të dhënat identifikuese të subjekteve tregtare përkatëse që kanë punësuar të ndërmjetësuarin/it.

4. Subjektet e licencuara raportojnë në rrugë elektronike në mënyrë periodike, çdo 6 (gjashtë) muaj, në drejtorinë përkatëse në ministrinë përgjegjëse për çështjet e punës, të dhënat për: (i) numrin e të ndërmjetësuarve të evidentuar me shtetësinë e tyre; (ii) subjektet tregtare dhe numrin e të punësuarve që kanë punësuar nga të ndërmjetësuarit.

5. Drejtoria përkatëse në ministrinë përgjegjëse për çështjet e punësimit krijon një databazë të të dhënave të marra në vazhdim.

6. Nëse gjatë kontrollit të subjekteve të licencuara konstatohet se nuk janë respektuar kushtet e kërkuara ose veprimtaria kryhet jo në përputhje me kuadrin rregullator në fuqi, subjekti i licencuar urdhërohet të plotësojë detyrimet brenda një afati të arsyeshëm. Nëse subjekti nuk përmbush detyrimet brenda afatit, drejtoria përkatëse në ministrinë përgjegjëse për çështjet e punësimit, i propozon ministrit, pezullimin ose heqjen e licencës.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I EKONOMISË, KULTURËS
DHE INOVACIONIT
Blendi Gonxhja



REPUBLIKA E SHQIPERISE
MINISTRIA E EKONOMISË, KULTURËS DHE INOVACIONIT
INSPEKTORATI SHTETËROR I PUNËS DHE SHËRBIMEVE SHOQËRORE

PROCESVERBAL INSPEKTIMI

Nr. _____

Datë _____

Bazuar në vendimin nr. 538, datë 26.5.2009, “Për licencat dhe lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet Qendrës Kombëtare të Licencimit (QKL) dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta”, i ndryshuar.

I. TË DHËNA TË PËRGJITHSHME

Emri tregtar: _____

NIPT-i: _____

Adresa: _____

Administratori/përfaqësuesi: _____

II. DOKUMENTE TË VERIFIKUARA

Nr.	Lloji i dokumentit	Original	Noterizuar
1.	Certifikatë për drejtuesin teknik 1. Diplomë për nivelin arsimor, të paktën, Bachelor. 2. Eksperiencë pune të vërtetueshme, të paktën 5 vjet, në fushën e menaxhimit të burimeve njerëzore dhe/ose fushën e shërbimeve të punësimit (CV, librezë pune dhe/ose çdo dokument, që shërben për vërtetimin e eksperiencës). 3. Kualifikime në fushën e menaxhimit të burimeve njerëzore dhe/ose në fushën e shërbimeve të punësimit të lëshuara nga një subjekt privat apo publik, i njohur nga legjislacioni në fuqi.	✓ ✓ ✓	✓ ✓ ✓
2.	Akt që provon marrëdhëniet e kërkuara të punës.	✓	✓
3.	Dokument që provon ngrirjen e një kapitali rezervë sigurie.	✓	✓
4.	Për mjediset: 1. Dokumente pronësie dhe/ose përdorimi me afat jo më pak se 1 vit. Ambienti ku do të zhvillohet aktiviteti duhet të jetë i njëjtë me adresën e deklaruar në Regjistrin Tregtar. 2. Planimetrinë e mjediseve firmosur dhe vulosur nga një arkitekt ose inxhinier i licencuar. 3. Aktmiratim higjieno- sanitar lëshuar nga Inspektorati Shtetëror Shëndetësor.	✓ ✓ ✓	✓ ✓ ✓
5.	Për teknologjinë/pajisjet Vetëdeklarim për përshtatshmërinë e pajisjeve, teknologjisë dhe mjediseve me standardet e shërbimit, duke cituar dokumentet, që pasqyrojnë cilësitë e garancitë e këtyre faktorëve	✓	✓
6.	Vetëdeklarim a) Veprimtaria që kërkon të kryejë (përshkrim i hollësishëm i saj). b) Përmbushja e detyrimeve të sigurimeve shoqërore e shëndetësore (për vitin e fundit të aktivitetit). c) Besueshmëria e ortakut, aksionarit, anëtarëve të organeve drejtuese të subjektit dhe drejtuesit didaktik (gjendja gjyqësore). ç) Respektimi i rregullave për mbrojtjen dhe përpunimin e ligjshëm të të dhënave personale.	✓	✓
7.	Ekstrakti i subjektit , ku pasqyrohet drejtuesi teknik. Drejtuesi teknik lejohet të regjistrohet në jo më shumë se dy subjekt	✓	✓



III. REZULTATI

Nga vlerësimi faktik të plotësimit të kriterëve përkatëse të licencimit nga inspektorati shtetëror, që mbulon fushën e punës rezulton:

Subjekti plotëson kushtet e licencimit	Subjekti nuk plotëson kushtet e licencimit
✓	✓

Për inspektoratin

1. _____
2. _____
3. _____

Për subjektin

1. _____

VENDIM

Nr. 148, datë 25.7.2024

**MBI IMPLEMENTIMIN E INTERVALIT
KOHOR 15 MINUTA NË OPERIMIN E
PROCESEVE NË TREGUN E
BALANCIMIT**

Në mbështetje të nenit 16, pika 5, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; si dhe të nenit 15, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 25.7.2024, pasi shqyrtoi relacionin me nr. 1511/1 prot., datë 22.7.2024, të për gatitur nga Drejtoria e Monitorimit të Tregut dhe Inspektimeve “Mbi implementimin e intervalit kohor 15 minuta në operimin e proceseve në tregun e balancimit”,

konstatoi se:

- ERE, me vendimin nr. 106, datë 2.7.2020, vendosi miratimin e Rregullave të Tregut Shqiptar të Balancimit të Energjisë Elektrike. Periudha nga miratimi i këtyre rregullave deri në datën 1 prill 2021 u shoqërua me ushtrimin *Dry Run* të rregullave në tregun e balancimit dhe në periudhën *Dry Run* u zbatua rezolucioni 1 orë.

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 108, datë 22.4.2021, ka miratuar “Rregullat e përbashkëta të shlyerjes për shkëmbimin e energjisë në përputhje me nenet 50(3) dhe 51(1), të Komisionit Rregullator të Bashkimit Evropian 2017/2195”. Këto rregulla aplikohen nga OST-të e Evropës Kontinentale anëtare të ENTSO-E, që nga data 1 qershor 2021. Aktualisht për OST sh.a., aplikimi i këtyre rregullave është duke u realizuar me intervalin kohor prej 1 ore. Në këtë kontekst, aplikimi i intervalit kohor prej 1 ore në tregun e brendshëm të balancimit të energjisë elektrike nuk sjell asnjë pasojë për këtë mekanizëm,

përkundrazi, aplikimi i afatit kohor prej 1 ore edhe në tregun e brendshëm të balancimit ndikon në harmonizimin e këtyre proceseve.

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 347, datë 27.12.2022, vendosi miratimin e Rregullave të Tregut të Energjisë Elektrike (rregullat e ALPEX-it, përkufizimet, procedura e tregtimit, si dhe procedura e klerimit dhe shlyerjes) dhe Bursa Shqiptare e Energjisë prej 12 prillit 2023 ka filluar operimin e tregut DAM në Shqipëri me bazë orare. Po ashtu, ALPEX sh.a., prej 1 shkurtit 2024, ka filluar edhe operimin e tregut DAM me bazë orare.

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 51, datë 2.4.2024, “Mbi kërkesën e OST sh.a., për intervalin kohor 1 orë në operimin e proceseve të tregut balancues, dhe nominimeve të transaksioneve tregtare” ndër të tjera, në pikën 1 të këtij vendimi, vendosi: “Pranimin e pjesshëm të kërkesës së OST sh.a., duke vendosur: periudhën kohore të proceseve në të cilat përfshihen edhe nominimet dhe llogaritjet respektive të disbalancave të kryhen me interval kohor prej 1 ore, për periudhën deri në 1 korrik 2024”.

- Përgjatë kësaj periudhe kohore të operimit të tregut të balancimit të energjisë elektrike në raportimet periodike të bëra nga OST sh.a. nuk është evidentuar problematikë në tregun e balancimit, e cila të lidhet me intervalin kohor prej 1 ore, në të cilin realizohen proceset ku përfshihen nominimet dhe llogaritjet respektive të disbalancave në treg.

- Po ashtu, pjesëtarët e tjerë të tregut të energjisë elektrike, të cilët operojnë në tregun e balancimit nuk kanë përcjellë në ERE përgjatë kësaj periudhe kohore shqetësime apo problematika që lidhen me intervalin kohor prej 1 ore, në të cilin realizohen proceset ku përfshihen nominimet dhe llogaritjet respektive të disbalancave në treg.

- Aktualisht, në tregun e balancimit të energjisë elektrike në vendin tonë operojnë katër ofrues të



shërbimit të balancimit (OSHB) të cilët janë: “KESH” sh.a., “Devoll Hydropower”/Shtatkraft, Ayen AS Energy dhe Kurum International OST sh.a., nëpërmjet *email*-it i është drejtuar këtyre ofruesve të shërbimit të balancimit ku kërkon nga ana e tyre të vlerësohet nëse janë teknikisht gati të kryejnë të gjitha ndryshimet e nevojshme për kalimin nga rezolucioni orar në rezolucion 15-minutësh për të gjitha proceset e tregut balancues, të cilat menaxhohen në portofolin e këtyre OSHB-ve.

- Tre nga këto ofrues të shërbimeve të balancimit (OSHB) respektivisht KESH sh.a., Devoll Hydropower/Shtatkraft, Ayen AS Energy, kanë kthyer përgjigjet përkatëse (evidentuara më sipër në këtë relacion) ku parashtrojnë pamundësinë e realizimit të rezolucioni 15-minutësh në tregun e balancimit.

- Shqipëria ka lidhje interkoneksioni me Greqinë, Malin e Zi dhe Kosovën. OST sh.a. ka komunikuar me operatorët e transmetimit të Malit të zi dhe të Kosovës të cilët kanë evidentuar pamundësinë e implementimit në një kohë të afërt të rezolucioni 15-minutësh në proceset bilaterale.

- Në rubrikën konsultime të ERE-s në datën 20.6.2024, është publikuar e plotë kërkesa e OST sh.a., përfshirë dhe komunikimet e OST sh.a. me palët e sipërcituara, në mënyrë që të realizohet konsultimi publik i gjerë me të gjitha palët e interesit dhe aktualisht në ERE nuk ka ardhur asnjë koment nga palët e interesit.

- Vlerësojmë se zgjatja e efekteve juridike të vendimit të ERE-s nr. 51, datë 2.4.2024, do t'i krijonte mundësinë OST sh.a. dhe pjesëtareve të tregut të balancimit, në mënyrë të veçantë, OSHB-ve, të cilët kanë bërë me dije në komunikimet përkatëse se kalimi në rezolucionin 15-minutësh kërkon ndërhyrje teknologjike në sistemet SCADA dhe në sensorët respektiv, për të bërë vlerësimet dhe ndërhyrjet përkatëse për kalimin në rezolucionin 15-minutësh në të ardhmen.

- Në të njëjtën kohë, shlyerjet e disbalancave bëhen me bazë mujore dhe *ex-post*, për rrjedhojë llogaritja për shlyerjen e disbalancave të muajit korrik realizohet pas përfundimit të këtij muaji, zgjatja e efekteve juridike të vendimit të ERE-s nr. 51, datë 2.4.2024, eliminon çdo problematikë për llogaritjen e tyre për muajin korrik 2024.

- Veç rëndësisë që ka harmonizimi i proceseve të skedulimit të OST sh.a. me operatorët e sistemeve të vendeve fqinje, një rëndësi të veçantë ka

harmonizimi i këtyre proceseve në tregun e brendshëm të energjisë elektrike. Aktualisht, kemi funksional tregun e një dite më parë i cili operohet nga ALPEX sh.a., me bazë orare dhe tregun e balancimit i cili operohet nga OST sh.a. me bazë orare. ALPEX sh.a. bën me dije se nuk ka në plan kalimin në produkte 15 minuta brenda vitit 2024, për këtë qëllim vlerësohet se zgjatja e efekteve juridike të vendimit të ERE-s nr. 51, datë 2.4.2024 dhe në muajt e parë të vitit 2025 do të krijonte evidenca më të qarta të ecurisë së proceseve të bursës përgjatë këtij viti.

- Në këto rrethana ERE, duke ndjekur dinamikën e zhvillimit të tregjeve të brendshme, por edhe të harmonizimit të proceseve me operatorët e transmetimit të vendeve të rajonit nëpërmjet OST sh.a. vlerëson zgjatjen e efekteve juridike të vendimit të ERE-s nr. 51, datë 2.4.2024.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Zgjatjen e efekteve juridike të vendimit të Bordit të ERE-s nr. 51, datë 2.4.2024, deri më 1.3.2025.

2. Drejtoria e Monitorimit të Tregut dhe Inspektimeve të njoftojë palët e interesit për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

**VENDIM****Nr. 149, datë 25.7.2024****MBI ZGJATJEN E AFATIT TË
VENDIMMARRJES SË BORDIT TË ERE-
s PËR SHQYRTIMIN E KËRKESËS SË
SHOQËRISË “AGE ERZEN” SHPK PËR
LICENCIM NË VEPRIMTARINË E
PRODHIMIT TË ENERGJISË
ELEKTRIKE**

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; nenit 14, pika 3 të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.6.2016, e ndryshuar; si dhe nenit 15 të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 25.7.2024, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 814/13 prot., datë 24.7.2024, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes “Mbi kërkesën e shoqërisë ‘Age Erzen’ sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike”,

konstatoi se:

- Shoqëria “Age Erzen” sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 814/3 prot., datë 31.5.2024, ka paraqitur kërkesën për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC “Hekali”, me kapacitet të instaluar 1940 kW, me vendndodhje në pellgun ujëmbledhës të lumit Erzen, Bashkia Tiranë.

- Bordi i ERE-s me vendimin nr. 127, datë 25.6.2024, vendosi të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë “Age Erzen” sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC “Hekali”, me kapacitet të instaluar 1940 kW, me vendndodhje në pellgun ujëmbledhës të lumit Erzen, Bashkia Tiranë.

- ERE botoi njoftimin në median e shkruar për fillimin e kësaj procedure (në datat 26.6.2024 dhe 27.6.2024) dhe në përfundim të afatit të pritjes së komenteve apo objeksioneve nga të tretët (data 5.7.2024), nuk rezultoi të ketë të tilla. Njoftimi për fillimin e procedurës u botua edhe në faqen zyrtare të internetit të ERE-s.

- Me shkresën nr. 1641 prot., datë 15.7.2024, ERE ka njoftuar dhe MIE-n mbi fillimin e procedurës së licencimit të kësaj shoqërie.

- Me shkresën me nr. 814/9 prot., datë 28.6.2024, ERE i është drejtuar shoqërisë duke i njoftuar vendimin e fillimit të procedurës dhe duke i kërkuar plotësimin e dokumentacionit të konstatuar të pa plotësuar apo të plotësuar pjesërisht. Me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 814/10 prot., datë 8.7.2024, shoqëria ka depozituar dokumentacion plotësues të aplikimit.

- Pas shqyrtimit të sa depozituar, ka rezultuar se mbetej ende dokumentacion për t’u plotësuar, ndaj ERE i është drejtuar shoqërisë me shkresën nr. 814/11 prot., datë 19.7.2024 për plotësim dokumentacioni. Në përgjigje, me shkresën e protokolluar së fundi në ERE me nr. 814/12 prot., datë 23.7.2024, shoqëria ka depozituar dokumentacionin plotësues të aplikimit.

- Në nenin 14, pika 3, të rregullores parashikohet se: Bordi mund të vendosë rast pas rasti për zgjatjen e afatit për marrjen e vendimit përfundimtar për pranimin ose refuzimin e aplikimit për licencë kur dokumentacioni nuk është i plotë, por jo më shumë se 30 ditë.

- Me qëllim shqyrtimin dhe analizimin e dokumentacionit të depozituar së fundi nga shoqëria dhe zhvillimin e ndonjë korrespondence të mundshme me të, vlerësojmë të zgjatet deri në 20 (njëzet) ditë afati i vendimarrjes së Bordit të ERE-s për aplikimin e shoqërisë “Age Erzen” sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të zgjasë deri në 20 (njëzet) ditë afatin e vendimarrjes së Bordit të ERE-s për kërkesën e shoqërisë “Age Erzen” sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike.

2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, të njoftojë shoqërinë “Age Erzen” sh.p.k. për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYETAR
Petrit Ahmeti**



VENDIM
Nr. 150, datë 25.7.2024

**MBI FILLIMIN E PROCEDURËS PËR
LICENCIMIN E SHOQËRISË “SUN’S
MIRACLE” SHPK NË VEPRIMTARINË E
PRODHIMIT TË ENERGJISË
ELEKTRIKE**

Në mbështetje të neneve 16 dhe 37, pika 2, germa “a”, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; neneve 4, pika 1, germa “a”, 5, pika 1, germa “a” dhe 10, pikat 1 dhe 3, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.6.2016, e ndryshuar; si dhe neneve 15 dhe 19, pika 1, germa “a” të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 25.7.2024, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 1652/1 prot., datë 24.7.2024, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes “Mbi kërkesën e shoqërisë ‘Sun’s Miracle’ sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike”,

konstatoi se:

- Shoqëria “Sun’s Miracle” sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1652 prot., datë 17.7.2024, ka paraqitur kërkesën për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltai me kapacitet të instaluar 2 *mw* dhe veprave ndihmëse, në zonën kadastrale nr. 3358, fshati Sheq Marinas, Njësia Administrative Topojë, Bashkia Fier, qarku Fier.

- Aplikuesi ka kryer pagesën e aplikimit sipas përcaktimeve të aneksit A të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.6.2016, e ndryshuar.

- Nga shqyrtimi i aplikimit, rezulton se aplikuesi ka plotësuar dokumentacionin në zbatim të përcaktimeve të nenit 9 të rregullores, për pikën 1.1, gerrat “a”, “b” dhe “c”; për pikën 1.2, gerrat “a”,

“b”, “c” dhe “d”; për pikën 1.3, gerrat “a” dhe “c”; për pikën 2.1, gerrat “b”, “c”, “d” dhe “f”.

- Nga shqyrtimi i këtij aplikimi konstatohet se nevojitet të plotësohet dokumentacioni në vijim:

NENI 9

Formati dhe dokumentacioni për aplikim

Pika 1. Dokumentacioni i përgjithshëm për të gjitha aplikimet për pajisje me licencë

Pika 1.3. Dokumentacioni financiar dhe fiskal

- **germa “b”:** Shoqëria duhet të depozitojë në ERE dokumentacionin përkatës për mbështetjen financiare ku të sqarojë/saktësojë me cilat fonde është bërë pagesa kundrejt sipërmarrësit.

Pika 2. Dokumentacioni specifik sipas tipit të licencës

Pika 2.1 Për t’u pajisur me licencë për prodhimin e energjisë elektrike, aplikuesi duhet të depozitojë gjithashtu:

- **germa “a”:** Për sa i përket numrit të njësisë gjeneruese dhe kapacitetit të instaluar të secilës, sa plotësuar nga shoqëria rezulton se tejkalohet kapaciteti total i përcaktuar në kontratën me MIE dhe lejet e tjera që disponon, ndaj do t’i kërkohej shoqërisë të bëjë saktësimet përkatëse. Gjithashtu duhet të depozitojë dokumentacionin teknik mbështetës në lidhje me jetëgjatësinë e pritshme të centralit fotovoltai.

- **germa “e”:** Subjekti ka depozituar VNM-në, e cila sipas afateve të vlefshmërisë rezulton se subjekti duhet të kishte filluar punimet brenda datës 24.6.2024. Gjithashtu, subjekti ka depozituar në ERE me vullnetin e tij dhe lejen e ndërtimit të datës 16.4.2024, por nga sa analizuar, subjekti nuk ka bërë me dije nëse ka nisur ndërtimin apo fazën në të cilën ndodhet, si e tillë vlerësohet të pyetet në vijim me qëllim edhe përlllogaritjen dhe vlerësimin e vlefshmërisë së kësaj VNM-je në kuadër të këtij aplikimi.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë “Sun’s Miracle” sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltai me kapacitet të instaluar 2 *mw*.

2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë aplikuesin dhe Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.



Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes dijeni, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrir Ahmeti

VENDIM
Nr. 151, datë 25.7.2024

**MBI NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN E
BORDIT TË ERE-s NR. 254, DATË
23.8.2023, "MBI LICENCIMIN E
SHOQËRISË 'G.S.K.' SHPK NË
VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË
ENERGJISË ELEKTRIKE NGA
CENTRALI FOTOVOLTAIK ME
KAPACITET TË INSTALUAR 2 mw"**

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar; të nenit 113, të ligjit nr. 44/2015, "Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë"; si dhe të nenit 15, të "Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s", miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 25.7.2024, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 781/4 prot., datë 24.7.2024, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes "Mbi një ndryshim në vendimin e Bordit të ERE-s nr. 254, datë 23.8.2023, 'Mbi licencimin e shoqërisë 'G.S.K.' sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik me kapacitet të instaluar 2mw'",

konstatoi se:

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 254, datë 23.8.2023, ka vendosur të licencojë shoqërinë "G.S.K" sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik me kapacitet të instaluar 2mw, për një afat 25-vjeçar, duke i lënë kusht shoqërisë të informojë ERE-n çdo

3 (tre) muaj, në lidhje me fillimin e punimeve të ndërtimit të centralit fotovoltaik, deri në datën 23.6.2024.

- ERE, në vijim edhe të ndjekjes së zbatimit të kushteve të vendimit nr. 254/2023, me shkresën nr. 781 prot., datë 18.3.2024, i kërkoj shoqërisë informacion në lidhje me fillimin e punimeve të ndërtimit të centralit fotovoltaik.

- Shoqëria, me shkresën e protokolluar në ERE nr. 781/1 prot., datë 25.3.2024, ka depozituar vendimin nr. 11, datë 26.12.2023, "Për miratimin e lejes së zhvillimit për objektin 'Ndërtimi i centralit gjenerues të energjisë elektrike fotovoltaike, me kapacitet të instaluar 2mw dhe veprave ndihmëse', me vendndodhje në Njësinë Administrative Dermenas, Bashkia Fier", gjithashtu ka informuar se është në proces të marrjes së lejes së ndërtimit, prandaj nuk ka filluar ende punimet.

- Duke qenë se shoqëria depozitoi dhe bëri me dije vetëm sa më sipër referuar, ERE, me shkresën nr. 781/2 prot., datë 3.7.2024, i solli në vëmendje detyrimet e kushteve të vendimit, e gjithashtu depozitim të VNM-së së rinovuar, pasi afati i vlefshmërisë ka qenë deri në datën 23.6.2024.

- Në përgjigje, shoqëria, me shkresën nr. 781/3 prot., datë 9.7.2024, ka depozituar informacion se ende nuk i është zbardhur leja e ndërtimit dhe si e tillë nuk ka nisur ende punimet për ndërtimin e centralit fotovoltaik. Për sa i përket VNM-së, shoqëria informon se ka aplikuar për rinovimin e saj dhe sapo të jetë pajisur do ta depozitojë atë në ERE.

- Aktualisht, duke marrë në konsideratë që ka përfunduar VNM-ja dhe subjekti ka bërë me dije se nuk ka nisur ende punimet por ka aplikuar për rinovimin e VNM-së, por ende nuk e ka depozituar atë, vlerësohet të ndryshohet pika 2, e vendimit të Bordit nr. 254/2023, duke i vendosur kushtin shoqërisë përpara se të fillojë veprimtarinë e operimit/ushtrimit të energjisë elektrike, shoqëria "G.S.K" sh.p.k. të depozitojë në ERE, VNM-në e rinovuar.

- Në nenin 113, të "Kodit të Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë" është parashikuar mundësia e ndryshimit të një akti, me nismën e vet organit, që e ka nxjerrë, duke përcaktuar dhe formën ligjore të këtij ndryshimi të aktit, e cila duhet të bëhet me një akt të ri me shkrim.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s



VENDOSI:

1. Pika 2, e vendimit të Bordit të ERE-s nr. 254/2023, ndryshon dhe bëhet:

“2. Përpara fillimit të operimit/ushtrimit të veprimtarisë së energjisë elektrike, shoqëria “G.S.K” sh.p.k. të depozitojë në ERE, VNM-në e rinovuar.”.

2. Pika 3, e vendimit të Bordit të ERE-s nr. 254/2023, ndryshon dhe bëhet:

“3. Ky vendim është objekt rishikimi nga ERE.”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrît Ahmeti

KORRIGJIM GABIMI MATERIAL

Në titullin e shtojcës që i bashkëlidhet vendimit të Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, “*Maçi kundër Shqipërisë*”, *kërkesa nr. 21051/10*, botuar në Fletoren Zyrtare nr. 141, datë 8.8.2024 bëhet korrigjimi si më poshtë:

Ishte:

SHTOJCË

Kërkesa që ngre ankimet sipas paragrafit 1, të nenit 6 të Konventës dhe nenit 1, të Protokollit nr. 1 (mosekzekutimi i vendimeve të brendshme dhe mungesa e një mjeti efektiv të brendshëm në këtë drejtim)

Bëhet:

SHTOJCË

Kërkesa që ngre ankimet sipas paragrafit 1, të nenit 6 dhe nenit 13 të Konventës dhe nenit 1, të Protokollit nr. 1 (mosekzekutimi i vendimeve të brendshme dhe mungesa e një mjeti efektiv të brendshëm në këtë drejtim)

KORRIGJIM GABIMI MATERIAL

Në vendimin nr. 506, datë 1.8.2024, të Këshillit të Ministrave, “Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 547, datë 9.8.2006, të Këshillit të Ministrave, “Për krijimin e Agjencisë Kombëtare të Burimeve Natyrore” të ndryshuar, botuar në Fletoren Zyrtare nr. 141, datë 8.8.2024, bëhet korrigjimi si më poshtë:

Në tabelën e parë, të aneksit 3, faqe 17685, bashkëlidhur vendimit, në nënndarjen e parë, të kolonës së parë, fjalët “për hidrocentralet” zëvendësohen me fjalët “për centralet”.

	Formati 61x86/8
--	-----------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2024

Adresa: Rr. "Nikolla Jorga", Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006



Çmimi 144 lekë